

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-065/13

Prishtinë, 28 May 2015

Në çështjen juridike të:

R. J.

Serbi

Pala ankuese

Kundër

K. e K.

Përfaqësues: Y. M. avokat

Kosovë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/132/2011 ((lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA49216) të datës 26 tetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 28 Maj 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM:

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R. J.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës
KPCC/D/C/132/2011 (për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin
KPA49216) të datës 26 tetor 2011.

Përmbledhja e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Më 3 dhjetor 2007, R. J. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur një kërkesë në AKP duke kërkuar të drejtën e pronësisë mbi objektet afariste dhe kompensimin për shfrytëzimin e pronës pa miratimin e tij. Prona e kërkuar është një punëtori teneqepunuese me sipërfaqe prej 60m² që ndodhet në ngastrën nr.585, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejme: pronë). Ai theksoi se e ka humbur posedimin e pronës për shkak të konfliktit të armatosur në periudhën 1998/99, duke cekur 12 qershorin 1999 si datën e humbjes. Ai pretendon se tani është e uzurpuar ilegalisht.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese ka dorëzuar këto dokumente:
 - Vendimin nr.365-471, të lëshuar nga Drejtoratin për Çështjet e Planifikimit Urban, Komunal dhe Juridiko-Pronësor të Komunës së Klinës më 26 shkurt 1997. Me këtë vendim, palës ankuese i është dhënë leja për ndërtimin e një objekti të llojit të përhershëm prej materialeve të forta. Ky dokument është vërtetuar negativisht në Drejtoratin për Urbanizëm në Komunën e Klinës (mungonin dokumentet);
 - Vendimin nr.351-678, të lëshuar nga Sekretariati për Ekonomi i Komunës së Klinës më 21 tetor 1987, me të cilin palës ankuese i është dhënë leja për ndërtimin e objekteve të përkohshme montazhe për punëtorinë teneqepunuese. Ky dokument është vërtetuar negativisht në Drejtoratin për Urbanizëm në Komunën e Klinës (mungonin dokumentet);
 - Vendimin br.313-1140, të lëshuar nga Sekretariati për Bujqësi i Komunës së Klinës më 25 shtator 1990, me të cilin palës ankuese i është lejuar hapja e punëtorisë teneqepunuese si punëtor i vet-punësuar teneqepunues. Ky dokument është vërtetuar negativisht në Drejtoratin për Urbanizëm në Komunën e Klinës (mungonin dokumentet);
 - Vendimin nr.353-461, të lëshuar nga Departamenti për Çështjet e Planifikimit Urban, Komunal dhe Juridiko-Pronësor të Komunës së Klinës më 19 dhjetor 1997, që tregon se një tokë me sipërfaqe prej 60 m² që ndodhet në ngastrën kadastrale nr.585 i është ndarë

palës ankuese. Ky dokument është vërtetuar negativisht në Drejtoratin për Urbanizëm në Komunën e Klinës (mungonin dokumentet);

- Vendimin nr.468, të datës 26 korrik 1991 të lëshuar nga PUC “Elektrokosovo” Prishtinë për ta kështur punëtorinë e palës ankuese në rrjetin e energjisë elektrike të kompanisë.
- Një aplikacion konsumatori që tregon se pala ankuese i ka paguar obligimet financiare për energjinë elektrike.

Sipas Raportit të Konsoliduar të Verifikimit të AKP-së të datës 7 tetor 2011, të gjitha dokumentet e lartcekura janë verifikuar negativisht nga Sekretaria Ekzekutive.

3. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin e lëndës KPA49216.
4. Më 12 nëntor 2008, ekipi njoftues i AKP-së e njoftoi kërkesën duke vendosur një shenjë aty ku pretendohet se ndodhet objekti afarist. Prona u gjet e uzurpuar nga I.B., i cili deklaroi se ai nuk pretendon ndonjë të drejtë ligjore mbi pronën, por ai e kishte lejen për të qëndruar në pronë. Ai iu referua një kontrate të qirasë të lidhur ndërmjet tij dhe palës ankuese.
5. Më 30 gusht 2010, Y. M. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) iu afrua AKP-së si palë përgjegjëse. Ai nënshkroi Njoftimin e Pjesëmarrjes dhe e kontestoi kërkesën në emër të Komunës së Klinës. Me autorizimin nr.464-4286, të datës 19 gusht 2010, të dhënë nga Komuna e Klinës, ai është autorizuar nga Komuna e Klinës që ta përfaqësojë komunën në çështjen juridike para AKP-së.
6. Ai pohoi se pronat e kërkuar zotërohet nga Komuna e Klinës. Për t’i mbështetur pohimet e veta, ai dorëzoi Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr.UL-71006024-00768, të datës 7 korrik 2010 të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Klinës. Dokumenti e tregon Kuvendin Komunal të Klinës si Bartës i së Drejtës Pronësore të ngastrës nr.585.
7. Më 26 tetor 2011, me vendimin KPCC/D/C/132/2011, KKPK-ja vendosi ta refuzojë kërkesën me arsyetimin se paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur ta dëshmojë të drejtën e tij pronësore të pretenduar mbi pronën.
8. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 17 dhjetor 2012.
9. Më 15 janar 2013, pala ankuese dorëzoi një ankesë në Gjykatën Supreme duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së.

Pretendimet e palëve

10. Pala ankuese i referohet vërtetimit jo të plotë të fakteve dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Pala ankuese deklaroi se ai e ka shfrytëzuar pronën e perënduar në përputhje me rregulloret në fuqi dhe se ai fillimisht ndërtoi një objekt afarist të llojit montazh në vitin 1987. Në vitin 1997 ai e rinovoi atë duke përdorur materiale të forta dhe e ka shfrytëzuar deri në vitin 1999, kur ishte larguar nga Kosova. Në pretendimet e veta, ai i paraqiti të gjitha vendimet e Komunës së Klinës në bazë të të cilave ai i kishte fituar të drejtat mbi pronën, si dhe një Fletë Poseduese nr.447, e cila nuk është gjetur nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së. Ai kërkoi nga Gjykata Supreme që ta pranojë ankesën e tij dhe të vendos që ta njoh të drejtën e tij për ri-posedimin e pronës së kërkuar.

Pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë

11. Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se prona e kërkuar është në pronësi të Komunës së Klinës sikurse përshkruhet në Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr.UL-71006024-00768, të datës 7 korrik 2010 të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Klinës dhe si e tillë nuk mund të jetë objekt i kthimit për cilëndo palë.
12. Për më tepër, pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se provat e paraqitura nga pala ankuese janë kundërthënëse, sepse fillimisht atij i është lejuar që ta ndërtojë një objekt të përhershëm prej materialeve të forta (Vendimi nr.365-471 i Departamentit për Çështjet e Planifikimit Urban, Komunal dhe Juridiko-Pronësor të Komunës së Klinës i lëshuar më 26 shkurt 1997), dhe pastaj organi i njëjtë kompetent ka vendosur që palës ankuese t'ia ndajë pronën që është objekt i kontestit (me Vendimin nr.353-461 të datës 19 dhjetor 1997). Veç kësaj, ai nuk ka paraqitur kontratën e lidhur me Komunën e Klinës lidhur me shfrytëzimin e tokës urbane komunale. Prandaj, pala përgjegjëse në ankesë pretendon se provat e paraqitur nga pala ankuese mund të jenë të falsifikuara.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

13. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Juridiksioni

14. Gjykata Supreme ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën.
15. Në këtë rast, bazuar në thëniet në ankesë, pala ankuese ka pasur posedimin e një pjesë të ngastrës nr.585 dhe se kishte pronësinë dhe ishte në posedim të objektit të cilin e kishte ndërtuar aty.
16. Sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2007/5 “*çdo person i cili **ka pasur** të drejtë të pronësisë, posedim ligjor apo çfarëdo të drejte tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave që janë të ndërlydhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur të periudhës 1998/1999, ka të drejtë rikthimi të së drejtës pronësore, si bartës i së drejtës pronësore*” ka të drejtë të paraqes kërkesë në AKP. Ligji përcakton qartë se vetëm e drejta e pronësisë, posedimi ligjor apo çfarëdo të drejte tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private mund të jetë objekt i procedurës para AKP-së. Paraqitësit të kërkesës i është dhënë e drejta e shfrytëzimit të një ngastre komunale me të drejtën për ndërtimin fillimisht të një objekti të përkohshëm dhe pastaj të një objekti të përhershëm prej materialeve të forta.
17. Në këtë drejtim, pala ankuese mund të ketë disa kërkesa legjitime për materialin dhe punën që ai e ka investuar në objekt, por në rast se ato kërkesa do të ishin legjitime, si kërkesa të rregullta detyrimore për ato duhet të vendosin gjykatat e rregullta e jo KKPK-ja.
18. Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të Komunës së Klinës se prona e kërkuar është në pronësi të Komunës, duhet të jetë e qartë se vet ngastra nuk ka qenë objekt i shqyrtimit të lëndës, i cili përcaktohet me kërkesën e ushtruar në AKP. Pala ankuese ka kërkuar ri-posedimin e punëtorisë teneqepunuese me sipërfaqe prej 60m², që ndodhet në ngastër. Bazuar në Ligjin për Procedurën Kontestimore neni 2, paragrafi 2.1 “*Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*”, Gjykata Supreme mund të vendos vetëm rreth çështjes lëndore që është përfshirë në kërkesë.
19. Pala ankuese, me ankesën e tij ka dorëzuar të njëjtat prova dhe i ka përsëritur të njëjtat pretendime që i ka bërë para KKPK-së. Nuk janë paraqitur prova të reja së bashku me ankesën dhe nuk kanë mundur të vërtetohen fakte të reja. Prandaj, pretendimi se vendimi është i gabuar dhe i bazuar në vërtetimin jo të plotë të fakteve është pa meritë. Po ashtu pa meritë është pretendimi për zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Paraqitësi i kërkesës/tani pala ankuese nuk e ka dëshmuar të drejtën

e pretenduar pronësore, prandaj kërkesa e tij është refuzuar. Ai nuk ka paraqitur prova të reja se në ndonjë moment para konfliktit të viteve 1998/1999 ai e kishte fituar të drejtën pronësore mbi pronat e paluajtshme në fjalë.

20. Gjykata Supreme vëren se KKPK-ja e ka bazuar vendimin e saj në faktin se Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së ka bërë verifikim negativ të dokumenteve në të cilat pala ankuese e ka bazuar kërkesën e tij. Për më tepër, Sekretaria Ekzekutive ka vërtetuar se ngastra ku ndodhet prona e kërkuar është e regjistruar në emër të Kuvendit Komunal të Klinës. Bazuar në këtë, KKPK-ja konstatoi se pala ankuese nuk ka arritur ta dëshmojë të drejtën e pretenduar të pronësisë mbi pronën e kontestuar. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme konstatoi se vendimi i KKPK-së ishte i drejtë dhe i mbështetur në baza faktike dhe procedurale. Në bazë të nenit 13.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 që parasheh se “*Gjykata Supreme e Kosovës si rregull vendos mbi ankesën bazuar në faktet e paraqitura në këtë gjykatë dhe të shqyrtuara nga Komisioni*”, Gjykata Supreme vendosi që ta refuzojë ankesën si të pabazuar.
21. Në bazë të të lartcekurave dhe sipas dispozitës së nenit 13.3 pika (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

1. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it